

## **Intervista e Presidentit Meta për emisionin “5 pyetje nga Babaramo” në Report TV**

**24 shkurt 2020**

**Gazetari (Ilir Babaramo):** Përse kjo thirrje? Në dijeninë time është një precedent, për herë të parë një President bën këtë thirrje, një kryetar shteti organizon një protestë.

**Presidenti Meta:** Nuk ka nevojë për një pyetje të tillë pavarësisht se juve ju takon, për arsye se të gjithë shqiptarët besoj edhe nën dritën e fakteve më të fundit e kanë kuptuar që në këtë vend kemi ende popullin shqiptar, aq sa ka mbetur edhe pse i tretur nga fenomeni i shpopullimit.

*Tashmë kemi dhe disa puçistë, të cilët kanë dalë zbuluar, të cilët kanë realizuar një grusht shteti, që duan të mbyllin aktin final të rrëmbimit mafioz në kundërshtim me Kushtetutën pikërisht dhe Gjykatën Kushtetuese, në mënyrë që anëtarët e ardhshëm të kësaj Gjykate të jenë të standardit Dvorani, të Artave, të Etildave dhe të gjithë atyre që për besnikëri të verbër apo për pengmarrje nga organizata që po drejton sot Shqipërinë janë gati të shkelin Kushtetutën me të dyja këmbët, të shkelin ligjin dhe çdo gjë. Të falsifikojnë dokumente shtetërore në mënyrë të strukturuar, kriminale, sikurse u demonstrua qartë edhe me provat e fundit.*

*Jo vetëm nga letërkëmbimi absurd, qesharak dhe mashtrues i kryetarit të KED-së, për fat të keq dhe i Kryetarit të Kuvendit me datën 8 nëntor. Por ajo që ishte edhe më e rëndë pas fakteve tronditëse të reja të zbuluara të funksionimit të kupolës së Ministrisë së Drejtësisë, ministre,*

*sekretar i përgjithshëm, drejtoreshë e Qendrës së Botimit të Fletores Zyrtare....*

**Gazetari:** Çfarë kanë bërë?

**Presidenti Meta:** Gjithë Shqipëria e ka marr vesh se çfarë kanë bërë, ata kanë falsifikuar.

**Gazetari:** Ata pretendojnë se kanë zbatuar ligjin?

**Presidenti Meta:** Zoti Babaramo, Kushtetuta është shumë e qartë, ligji është shumë i qartë dhe aq më tepër drejtuesit e Ministrisë së Drejtësisë janë garantë, jo vetëm të veprimeve të tyre si institucion në respekt të Kushtetutës dhe të ligjit, por ata janë garantë dhe e kanë për detyrë dhe për institucionet e tjera, edhe për Ministrinë e Bujqësisë, edhe për një projektligj, që çon kjo ministri në qeveri apo në parlament apo një vendim, kalon tek Ministria e Drejtësisë për të parë a është në përputhje me Kushtetutën dhe a është në përputhje me ligjin.

*Çfarë kanë bërë këta? Këto janë tashmë shumë të qarta, sikurse sot kemi bërë edhe depozitimin e kallëzimit penal për këtë grup strukturor kriminal të Ministrinë e Drejtësisë në SPAK.*

*Këta kanë botuar në mënyrë të paligjshme një vendim të një institucioni tjetër të pavarur, që nuk ka lidhje fare me Ministrinë e Drejtësisë, siç është Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, që e kishte botuar vendimin atje ku ja ka caktuar ligji këtë vendim, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në seksionin e dedikuar posaçërisht për KED-në dhe ky ishte një vendim siç ishin dhe tre të tjerat për katër vakancat e Presidentit dhe të Kuvendit.*

*Pra, në këtë mënyrë mafioze ata duke bërë një botim të karakterit propagandistik pa u kërkuar sipas ligjit zyrtarisht askush, sepse jo vetëm që ligji i ka përjashtuar botimet e KED-së në Fletoren Zyrtare, - janë të gjitha institucione të parashikuara me ligj se kush ka të drejtë të botojë, - por dhe mënyra se si botohet është e përcaktuar, shprehimisht.*

*Ata nuk kanë pasuar asnjë kërkesë zyrtare as nga vetë Dvorani, i cili përsëri do të mbante një përgjegjësi të rëndë penale, përveç veprave të tjera që ka konsumuar, as nga Kuvendi nuk është kërkuar. Jo vetëm kaq, por kur e kanë çuar për botim pastaj me një numër tjetër protokoli të mëpasshëm, që provohet nga vetë dokumentet zyrtare kanë marrë një letër nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit thjesht për ta përdorur si alibi në rast se kjo do të zbulohet më pas, edhe siç është zbuluar prej kohësh, por ne menduam ta denoncojmë tani.*

*Për arsye sepse ata në mënyrën më të papërgjegjshme thirrën kot mëkot Komisionin e Venecias.*

*Kushtetutën tonë e ka shkruar vetë Komisioni i Venecias.*

*Është shkruar sipas rekomandimeve të qarta dhe të pastra dhe të paimterpretueshme gërmë për gërmë të Komisionit të Venecias.*

*Ata një ditë përpara se Komisioni të mbërrinte natën e bën fakt të kryer miratimin e ligjit të betimit të Lana, në mënyrë që me një ligj anti-kushtetues, kur Kushtetuta e thotë shumë qartë që ky proces betim bëhet vetëm te Presidenti i Republikës, të bëjnë fakt të kryer që të çojnë në Gjykatë Kushtetuese juristë të standardit të Dvoranit, të Artave apo*

*të Etildave në mënyrë që të uzurponin dhe institucionin e fundit që e lanë të paralizuar për gati dy-tre vjet, por edhe njëkohësisht dhe për ta kapur atë një herë e përgjithmonë dhe për të ligjëruar sipas tyre gjithë veprimtaritë e tyre anti-kushtetuese të deritanishme.*

*Por edhe tashmë çka përbën një ekzekutim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shtetit të së drejtës në Shqipëri, të llogaridhënies në Shqipëri që dhe kështu siç është rrëzuar totalisht dhe të shuajnë çdo mundësi për ndryshime demokratike në vendin tonë dhe mbi të gjitha të asgjësojnë garantimin e të drejtave të qytetarëve shqiptarë që janë të rëndësishme.*

Ju thatë çfarë kanë bërë? Kjo që kanë bërë ata është njësoj - për ta kuptuar ju - që unë të shkoj dhe të regjistroj tek Hipoteka pronën tënde, ta regjistroj si pronën time.

Meqenëse kam këtë mundësi, kam një institucion në varësi edhe mund ta bëj këtë gjë, kjo mua më duket se është shumë e qartë. Pasojat janë shumë të rënda.

*Së pari, kanë shkatërruar besueshmërinë të reforma në drejtësi, sepse të përpiqesh të vjedhësh Gjykatën Kushtetuese në mënyrë mafioze, në mënyrë anti-kushtetuese, në mënyrë të paligjshme. T'i rrëmbesh kompetencën kushtetuese një pushteti tjetër, Kryetarit të Shtetit, ta kthesh Gjykatën Kushtetuese nga një garante e mbrojtjes së Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në një celulë mafioze, që do të veprojë si organizata rilindëse e KQZ-së, që organizon zgjedhje njëpalëshe.*

Kjo do të thotë që unë që kam dikë në varësi, se ajo ka në varësi dhe hipotekat, ta marr pronën tënde dhe ta

regjistrojë në emrin e vet. Si mendon ti, duhet të gjithë shqiptarët ta pësojnë këtë gjë? Se shumë prej tyre e kanë pësuar që ta kuptojmë këtë gjë, përveç cenimit të shumë e shumë të drejtave të tjera.

Kjo do të thotë që ndodh një aksident, ndodh një krim dhe ti të fshehësh gjurmët e krimit, apo vendos gjurmët e gishtave të tu, që i pafajshëm, aty ku ka ndodhur krimi që e ka bërë dikush tjetër dhe të shkosh të dënohesh ti dhe të shpëtojnë ata të tjerët.

Kjo do të thotë rrëzim i shtetit të së drejtës dhe është bërë në mënyrë të ndërgjegjshme, sepse kanë qenë të paralajmëruar në mënyrë të vazhdueshme dhe u është kërkuar bashkëpunim nga Presidenti i Republikës, Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dhe të gjithë institucioneve për të mos ardhur te kjo çmenduri që “është perla më e madhe e zbatimit të reformës në drejtësi”.

**Gazetari:** Përse nguteni atëhere drejt datës 2 mars, për të protestuar në rrugë para Kryeministrisë kur ambasadorët më të rëndësishëm në Tiranë thonë që duhet të prisni një ekspertizë të Komisionit të Venecias?

**Presidenti Meta:** Ambasadorët këtë gjë e thanë përpara dhe për mendimin tim, ata, bënë veprim shumë të gabuar.

*Sepse ata dolën jashtë statusit të tyre diplomatik në Republikën e Shqipërisë. Mendo sikur ambasadorja e Shqipërisë në Romë të vinte në diskutim dekretin e Presidentit të Italisë! Do ta kishin paketuar, ambalazhuar, siç paketohen ato plaçkat që sillen me DHL, dhe për 24 orë e kishe në Rinas. Megjithatë, ata e bënë këtë gjë, edhe*

*pseunë, u thashë që kjo nuk është kërkesë për Venecian se, është qesharake.*

Sepse Venecia e ka shkruar që Gjykata Kushtetuese ndërtohet në mënyrë të balancuar nga Presidenti, si kryeri i Shtetit dhe është i pari Presidenti, nga Parlamenti dhe ka parasysh parlament demokratik, jo gjysmë-Parlament si ky i joni që është në gjendje anti-kushtetuese prej një viti me 122 deputet me letra nga 140 dhe nga Gjykata e Lartë.

Vetë Venecia ka thënë që edhe radha do përcaktohet në Kushtetutë dhe do përcaktohet edhe në ligj, një për një, për çdo emër. Pse? Sepse e ka thënë Venecia vetë, na e ka dërguar me letra që atëherë kur e kemi bërë. Sepse mund të ndodhi që Presidenti dhe shumica në Parlament të jenë të një linje politike.

**Gazetari:** Ndërkohë socialistë thanë që, ju nuk e respektuat afatin 1-mujor, për të përzgjedhur emrin e dytë...

**Presidenti Meta:** Se çfarë thonë socialistët.... specialistët, jo socialistët. Socialistët janë seriozë, këta janë rilindas.Por, çfarë thotë Venecia, edhe radha kushtetuese është e rëndësishme duhet të jetë e balancuar.

*Mund të ndodhë që Presidenti dhe shumica në Parlament të jenë të një linje politike dhe t'i plotësojnë të 6 vendet me njëherë dhe bëjnë kuorumin, rimarrin çdo gjë, mbarojnë punë. Në Gjykatën Kushtetuese nuk ke as mendim oponent, përbën një rrezik kapja politike e Gjykatës Kushtetuese. Kjo ka qenë dhe është shumë e qartë, kjo është dhe arsyeja pse ata nuk e pritën Venecian.*

*Ata, e kërkuan gjoja Venecian, për të relativizuar përgjegjësitë penale të Dvoranit se ai, nuk është vetëm ai, ka bërë bashkëpunëtorë të shumtë. Ja dolën disa bashkëpunëtorë, por do dalin dhe të tjerë. **Kam dyshime, që për fat të keq do dalin dhe bashkëpunëtorë ndërkombëtarë.** Më këtë akt dhe tentativë të pastër të grushtit të shtetit.*

Unë kam respektuar Venecian, e kanë kërkuar ata, se unë nuk mund të kërkojë Venecian e të vë në diskutim diçka që e kam bërë në përputhje më Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Por, meqenëse e kërkuan ata, shumë mirë bënë që e kërkuan ata, kërkova edhe unë, për aktet që ka bërë Kuvendi në mënyrë që ata, të shikojnë se çfarë ka ndodhur realisht dhe jam i sigurt që kur unë të shkoj në seancën plenare në Venecia, që po më çon Rilindja, ata do ta kuptojnë edhe më qartë se çfarë ka ndodhur këtu.

**Gazetari:** Ju thoni që Kuvendi bëri një akt të njëanshëm

**Presidenti Meta:** Cilin akt të njëanshëm?

**Gazetari:** Që nuk respektoi, afatin e ardhjes së Komisionit të Venecias për të dhënë gjykimin e tij.

**Presidenti Meta:** Kuvendi i thirri dhe për çështjen e ligjit dhe pyetjet kryesore ishin për këtë gjë.

**Gazetari:** Keni dijeni si ka reaguuar Venecia lidhur me këtë fakt të kryer?

**Presidenti Meta:** Unë nuk flas as në emër të Venecias, as të ndërkombëtareve dhe as të ambasadave. Unë flas në emër të Kushtetutës dhe të popullit shqiptar. Kushtetutën këta e kanë bërë leckë, sepse janë njerëz pa dinjitet, janë njerëz pa atdhe, janë një bandë falsifikatorësh siç e shikojmë shumë qartë në kupolën më të lartë të shtetit.

*Institucionet këtu kanë rënë! Pse, kanë rënë institucionet? Sepse Presidenti u kërkon në mënyrë të përsëritur me shkresa zyrtare të dokumentuara, të protokolluara dhe vetë nga Kuvendi i Shqipërisë, bashkëpunim me Kuvendin. I kërkon KED-it bashkëpunim, i kërkon Dvoranit bashkëpunim, respekto Kushtetutën, respekto këtë, respekto atë. Gjëja më qesharakë është sesi mund të shpiket afat nga Dvorani.*

*Afatin e ka të qartë Kushtetuta, për çdo vakancë janë 30 ditë dhe Presidenti për vakancën e parë veprimi menjëherë, dhe i bëri thirrje Kuvendit dhe ia çoi edhe dekretin e parë dhe i tha, unë veprova, tani vepra dhe ti për të parin, që unë të veprojmë për të dytin timin, apo të tretin në radhë siç e vendos Kushtetuta, siç me të drejtë i ka renditur edhe KED-ja.*

*Sepse KED-ja e ka bërë renditjen sipas Kushtetutës, President, Parlament. President, Parlament.*

*Nuk e ka bërë President, President, Parlament, Parlament.*

*U gajasën të gjithë kur kishin thënë; po mirë, ti pse ia dërgove Presidentit këto të dyja menjëherë dhe nuk ja dërgove të paktën të katërta në një ditë siç edhe u miratuan. Po nuk pata kohë kishte thënë, 6 ditë se kisha disa punë të tjera administrative, po fotokopjoja. Po mirë, nuk pate kohë, po pse nuk ja dërgove Parlamentit dy të parat, meqë ti*



*lidhjen e ke më direkte me Parlamentin dhe zotin Ruçi, por ia dërgove Presidentit.*

Sepse kur Presidenti të dërgon ty një shkresë si Ardian Dvorani, këtë ia dërgon dhe Kryetarit të Kuvendit edhe Avokatit të Popullit, që është institucioni që me Kushtetutë monitoron gjithë veprimtarinë e KED-së. Por, këtë ja dërgon të gjitha ambasadave të BE-së, që paguajnë këtu 200 milionë euro, ia dërgon dhe Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ndërkohë dhe të lutet në mënyrë të vazhdueshme, të lutem të bashkëpunojmë, që të mos të kemi përplasje midis institucioneve, sepse edhe emrat janë të parazgjedhur në mënyrë të tillë që të kishte përplasje.

Sepse ishte një gjë mjaft qesharake, ishin 6 emra, ndërkohë që sipas Kushtetutës dhe frymës së ligjit duhet të ishin minimumi 12 emra, pra nga 3 emra të ndryshëm për çdo vend.

Ndërkohë ti krijon këtë situatë kaq të turpshme dhe skandaloze, sepse mendon që anëtari i Gjykatës Kushtetuese është një portokalle aty të bahçja e Presidencës, që ti mund të dalësh nga muri ta vjedhësh dhe të ikësh me vrap. Kjo është historia për ta kuptuar më thjeshtë.

**Gazetari:** Ju thoni që Partia Socialiste po tenton të kapë...

**Presidenti Meta:** *Rilindja, kam respekt për Partinë Socialiste. Sepse në vitin 1998, Kushtetutën e ka bërë Partia Socialiste, dhe në fakt kam bërë një gabim sot, se hapi i parë i grushtit të shtetit është uzurpimi i Partisë Socialiste dhe*

*vrasja e demokracisë në atë parti dhe e ndjenjës së përgjegjësisë para shtetit, para kombit dhe shantazhimi i gjithë atyre njerëzve, shumë prej të cilëve janë njerëz të nderuar, të cilët janë detyruar dhe pse e dinë që shkelin Kushtetutën në mënyrë të vazhdueshme. Siç është edhe rasti i dividendit me fuqi prapavepruese për uljen e tatimit, por nuk kanë çfarë bëjnë, sepse janë të shantazhueshëm, sepse janë në presion të madh të shantazhit.*

**Gazetari:** Ju në hapin e shtatë thoni, që synohet shkarkimi juaj me porosi të UDB-së. Përse kjo? UDB-ja kaq e fuqishme të jetë në Shqipëri sa të shkarkojë Kreun e Shtetit?

**Presidenti Meta:** Unë mendoj që përderisa ajo edhe për shumë eksponentë edhe mediatikë siguron hapësira pa fund televizive, të cilët i dalin në mbrojtje gjithë këtij grushti të shtetit ndodhur prej kaq vitesh, të cilët sulmojnë në mënyrë më rrugaçërore Presidentin e Republikës për të vetmen arsye, sepse ka mbajtur ato qëndrime që i takon të mbajë sipas Kushtetutës, edhe për shtetin e Kosovës edhe për çështjen kombëtare. Të cilat, kuptohen janë bërë një pengesë për avancimin e atyre skenareve ogurzi që defaktorizojnë Kosovën dhe njëkohësisht defaktorizojnë shqiptarët në këtë rajon. Për llogari të kujt shkon kjo zoti Babaramo?

**Gazetari:** Ngelet ta gjykojnë njerëzit!

**Presidenti Meta:** Po, patjetër, njerëzit i kanë sytë hapur dhe do t'i kenë edhe më shumë nga faktet e reja në ditët e ardhshme.

**Gazetari:** Çfarë faktesh prisni të dalin?

**Presidenti Meta:** Tani ju e dini që vazhdimisht ne jemi vigjilentë, jemi të habitur nga kjo gjë që ka ndodhur. Jemi të habitur nga guximi i tepruar dhe i marrë që tregon pengmarrjen e këtij grupi. Sepse ky grup vepron në kushtet e pengmarrjes, është rekrutuar diku tjetër, sepse veprimet që ata po bëjnë...

**Gazetari:** E lidhni këtë me projektin e ndarjes së Kosovës?

**Presidenti Meta:** *Unë këtë e lidh me shumë projekte, që në fund të ditës kanë të bëjnë me instalimin e grushtit të shtetit si një regjim arbitrar në funksion të organizatave ndërkombëtare të huaja...*

**Gazetari:** Si mund të bëjë qeveria një grusht shteti zoti President?

**Presidenti Meta:** *...Dhe të shpopullimit të Shqipërisë. Grushti i shtetit është i disa formave dhe ajo që ka bërë qeveria – shikoni të gjitha hapat – është pikërisht që përmes uzurpimit të kompetencave kushtetuese të funksioneve të tjera, përmes asgjësimit të balancës së pushteteve dhe ndarjes së pushteteve në vend ka arritur të kontrollojë të gjitha institucionet që do të thotë se një pakicë kontrollon të gjithë jetën institucionale dhe ekonomike të një vendi.*

Dhe e vendos këtë në shërbim të tjetërkujt, jo të popullit të vet.

**Gazetari:** Të kthehemi te data 2 mars. Çfarë pritet të ndodhë pasditen e 2 marsit?

**Presidenti Meta:** *Më 2 mars unë u jam drejtuar qytetarëve shqiptarë. Atyre do t'u isha drejtuar edhe në dhjetor me rastin e Lëvizjes Studentore, por ajo u shty për disa arsye. Tani më 2 mars unë do t'i drejtohem të gjithë popullit shqiptar dhe të gjithë botës ndërkombëtare për t'u bërë të qartë, që mbi Kushtetutën qëndron vetëm sovraniteti dhe vullneti i tij.*

*Sepse Kushtetuta e Shqipërisë, që për fat të keq është sakatuar e plagosur në mënyrë sistematike nga vitin 1998 e këtej, u votua në vitin 1998 me referendum mbarë popullor, nga i gjithë populli shqiptar. Kështu që fjalën do ta ketë populli, Presidenti u ka bërë thirrje të gjithëve vetëm me flamurin kuqezin për të rivendosur të gjithë sistemin e rënë kushtetues, demokratik dhe llogaridhënës në vendin tonë.*

**Gazetari:** Ju do të mbani një fjalim, do të ketë miting? Çfarë do të jetë, si do jetë e organizuar?

**Presidenti Meta:** *Qytetarët janë ftuar në bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Sot publikuam edhe orën, më 17:00, çdo ditë ka detaje të tjera. Parullat besoj janë të qarta, jo grushtit të shtetit dhe jo shpopullimit të vendit. Sepse të dyja këto lidhen me njëra-tjetrën. Për Kushtetutën, për Shqipërinë, të gjithë të barabartë përpara ligjit. Besoj se të gjitha këto shkojnë në përputhje të interesit të çdo qytetari të Shqipërisë, përveç një pakice puçistësh.*

**Gazetari:** Ju çfarë keni si synim më datën 2 mars? Të sensibilizoni opinionin publik shqiptar dhe ndërkombëtar apo të rrëzoni këto që ju i quani puçistë?

**Presidenti Meta:** Objektivat e mia janë shumë të qarta. E para, një herë të ndërgjegjësoj të gjithë qytetarët shqiptarë

për grushtin e shtetit. Së dyti, t'u bëj të qartë që instalimi i grushtit të shtetit asgjëson përfundimisht liritë dhe të drejtat e tyre demokratike që garanton në letër sot Kushtetuta e Shqipërisë, por që është e pamundur t'i garantojnë institucionet e kapura në këtë mënyrë, siç e shohim, kriminale dhe mafioze kjo bandë për fat të keq në pushtet.

Si mund të garantojë Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë e zgjedhur në një mënyrë mafioze, në një mënyrë anti-kushtetuese në kundërshtim me Kushtetutën dhe përmes këtyre falsifikimeve kaq të tmerrshme që bëhen nga kupola e ministrisë, që bëhen nga kryetari i KED-së, i cili duhet të vepronte i pari në përputhje me ligjin, i pari në përputhje me Kushtetutën. Që bëhen nga Kuvendi i Shqipërisë.

Si mund të besojnë më këta që mund të jenë të garantuar pronat e tyre, të drejtat e tyre, liria e tyre dhe mund të jenë të sigurt në këtë vend. Shumë thjeshtë, kjo që ka bërë Ministrja e Drejtësisë është sikur unë të shkojë të regjistroj pronën tënde zotëri si pronën time dhe hajde gjeje ti pronën kur unë i kap të gjitha gjykatat, të të gjitha shkallëve në Republikën e Shqipërisë. Ku do e marrësh pronën ti? Asgjëkundi.

**Gazetari:** Nëse do të ketë akte dhune, çfarë do të ndodhë?

**Presidenti Meta:** *Nuk ka asnjë arsye që të ketë asnjë akt dhune! Nëse segmente të qeverisë dhe të bandave të saj do të provokojnë gjëra të tilla, ajo përgjegjësi do të jetë e tyre. Populli shqiptar në mënyrën më paqësore do të bëjë një manifestim historik në mbrojtje të Kushtetutës. Dhe është i thirrur për t'i tregua të gjithë botës se ku qëndron populli shqiptar në raport me Kushtetutën dhe kush janë puçistët, të*

*cilët duan të asgjësojnë lirinë dhe demokracinë, shtetin ligjor në këtë vend, të përdhunojnë përfundimisht edhe reformën në drejtësi, duke instaluar përfundimisht atë që unë e kam quajtur me shumë të drejtë për fat të keq “Ramaformën”.*

**Gazetari:** Përse ju keni besim zoti President se do të keni sukses në këtë protestën tuaj që keni thirrur në 2 mars kur gjatë gjithë vitit të kaluar opozita ka bërë në mënyrë të vazhdueshme protesta dhe produkti i tyre ka qenë nul? Qeveria ka vazhduar të funksionojë në normalitetin e saj.

**Presidenti Meta:** Se çfarë ka opozita dhe se çfarë bën opozita, kjo është një përgjegjësi e opozitës. Unë mendimet e mia ia kam dhënë opozitës për shumë veprime që i kam gjykuar të gabuara, që nga lënia e mandateve dhe i kam thënë se çfarë do të ndodhë. Që nga mospjesëmarrja në zgjedhje, që nga dyzimi për të marrë apo jo pjesë në zgjedhjet lokale të 13 tetorit, megjithatë është çështje e saj. Për mua nuk asnjë shqetësim. Opozita bën zgjedhjet dhe veprimet e saj. Unë si President i Republikës i kam bërë të gjitha veprimet edhe me opozitën, edhe me mazhorancën. Kam bërë çdo gjë që situata të mos vijë këtu.

Shikoni dokumentet zyrtare të Presidentit të Republikës me Kryetarin e Kuvendit.

Se çfarë vullneti ka Presidenti i Republikës....

**Gazetari:** Këto ia treguar zoti Basha kur erdhi në zyrën tuaj herën e fundit?

**Presidenti Meta:** ...për të bashkëpunuar me Kuvendin e Shqipërisë. Jo vetëm me Kryetarin e Kuvendit, por edhe mesazhet zyrtare publike drejtuar të gjithë deputetëve dhe duke iu lutur. Zotërinj, ju lutem, kjo është çështje shumë e

rëndësishme, lexoni nenin kaq të Kushtetutës, lexoni këtë, të shmangim lojërat që do të dëmtonin Gjykatën Kushtetuese, reformën në drejtësi, do të krijojnë përplasje institucionale, sepse unë ua kam thënë prej kohësh, ua kam thënë të gjithëve. Te Gjykata Kushtetuese është vija e kuqe dhe e kuqe flakë.

Sepse këtu vihet në diskutim jo vetëm demokracia, që është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe është jetike për një vend që ka qenë Koreja e Veriut 30 vite më parë dhe që është kthyer në kushtet, jo vetëm të një partie-shtet, por të një celule mafioze. Sepse ata kanë asgjësuar demokracinë dhe llogaridhënien brenda vetë partisë së tyre, por është një rrezik edhe për çështjen kombëtare dhe për ekzistencën tonë shtetërore si një shtet, i cili pavarësisht nga mangësitë që ka patur herë pas here, por të paktën në 100 e ca vite ka patur arritjet e veta. Kurrë nuk kemi qenë më keq se kaq.

**Gazetari:** A jeni penduar që ata turmë njerëzish, atë fluks të madh, të jashtëzakonshëm njerëzor që ishte drejtuar për nga Parlamenti ju e stopuat, duke bërë thirrje që të ndalonte protesta? Jeni penduar për atë gjest?

**Presidenti Meta:** *Jo, absolutisht nuk jam penduar për të gjitha thirrjet e mia drejtuar opozitës për të ruajtur qetësinë dhe për të mos kryer asnjë akt problematik ndaj institucioneve. Sepse unë jam i mendimit, që kur dikush merr përsipër të drejtojë diçka, ai duhet të marrë i pari përgjegjësinë për gjithçka. Në rastin konkret për rivendosjen e rendit kushtetues, unë përgjegjësinë nuk ia lë popullit.*

*Unë përgjegjësinë e marr vetë i pari dhe kam plotësisht të drejtën që përmes dekreteve të rivendos rendin kushtetues*

*në vend në rast se parlamenti do të vazhdojë të thellohet më tej në puçin e tij dhe në veprimtarinë e tij anti-kushtetuese dhe anti-kombëtare. Dhe përgjegjësinë e marr unë. për mua ka rëndësi që populli të përgjigjet dhe unë jam i bindur që populli do të përgjigjet. Do t'i zbatojë populli dekretet e Presidentit meqenëse institucionet janë të kapura dhe praktikisht të vdekura në kuptimin e funksionimit.*

**Gazetari:** Si mund të çkapen këto institucione?

**Presidenti Meta:** Të gjitha nuk do t'i zbardhim këtu, çdo ditë do të ketë elemente të ri.

**Gazetari:** Sepse ju përshkruani një puç, përshkruani një një celulë mafioze në krye të shtetit...?

**Presidenti Meta:** Çfarë mund të jetë tjetër?! Në qoftë se ministrja e Drejtësisë është e ndërgjegjshme deri ditën e shtunë në punë, sepse të hënën parlamenti duhet ta konsiderojë atë që i takon Presidentit, do t'ia rrëmbejë anëtarin e Gjykatës Kushtetuese Presidentit, sepse do të shtojë numrat, shumicën në Gjykatën Kushtetuese. Që të mos ketë më gjykim për zgjedhjet vendore të 30 qershorit.

Por ligjërisht, fakti që një parti e vetme, 100% kontrollon të gjithë pushtetin vendor, të gjitha bashkitë, të gjithë këshillat bashkiakë, që rriten taksat në mënyrë katastrofike në të gjithë pushtetin vendor në Shqipëri, që rriten borxhet dhe këto prapë do të paguhen me taska të reja, dhe askush nuk të jep llogari, dhe askush nuk kërkon një llogari. Ndërkohë që tjetërsohen në mënyrë të paligjshme të gjitha këto pasuri kulturore, të gjithë këtë trashëgimi historike për qëllime të tjera, në mënyrë që..., përse bëhet e gjithë kjo gjë?! Që një pakicë jo vetëm ta



përrjashtojë shumicën e e njerëzve me çdo vendimmarrje, por mundësisht që ta shpopullojë Shqipërinë nga të gjithë njerëzit problematikë, jo si ata “çunat e Dibrës”, por problematikë në kuptimin që kërkojnë të drejtat e tyre, që kërkojnë garancitë e tyre. Dhe që t’i zëvendësojnë pastaj: i keni dëgjuar thirrjet që iu drejtuan atyre në Afrikë që hajdeni të punoni në Shqipëri! Se ata janë më të bindur. Se ata janë më të varfër. Se ata mund të flenë edhe njëqind vetë në një kabanon dhe ata mund të shfrytëzohen shumë më lirë se sa qytetarët shqiptarë, të cilët sidoqoftë në tridhjetë vite përjetuan, pavarësisht nga privimet e ndryshme, një progres në kuptimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

**Gazetari:** Zoti President, përse duhet që njerëzit të vinë, t’i besojnë thirrjes suaj, kur do të vinë, do të rrinë një orë apo dy orë dhe pastaj do të shkojnë në shtëpi? Dhe pastaj ishte ashtu siç ishte dhe protesta vazhdoi ashtu siç ishte?

**Presidenti Meta:** Qytetarët duhet të tregojnë vullnetin e tyre. Presidenti do të tregojë vullnetin e tij. Presidenti po del në fushën e betejës për t’i bërë paralajmërimin e fundit grupit puçist. Populli shqiptar, në qoftë se është mirë dhe mendon se Presidenti nuk është rregull, le të vazhdojë të rrijë në shtëpi, të durojë çdo ditë thundrën e një pushteti shtypës. Edhe më të larta do t’i ketë taksat. Edhe më të shumta do të jenë padrejtësitë. Do të vdesin njerëzit, do të vrasin veten për 12 mijë lekë si ai tjetri apo të tjerët që nuk kanë paguar energjinë për aq apo për kaq muaj. Apo tërë njerëz që dënohen për gjëra fare të vogla, por që duhet të dënohen në bazë të ligjit apo ministren me etikë të Drejtësisë se si flet për sukseset e reformës, ndërkohë që është në krye të një bande që falsifikon dhe bën shumë vepra penale për të rrëmbyer me vetëdije të plotë, se ia

kërkon partia, Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë. Ia rrëmben këtë kryetarit të shtetit, të cilit Kushtetuta ia ka dhënë në mënyrë të qartë atij dhe vetëm atij.

Dhe jo më kot betimi është te Presidenti, siç e theksonte me shumë të drejtë Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe e ka theksuar edhe Venecia. Se te Presidenti i Republikës nuk betohen vetëm ata të tre që zgjedh Presidenti. Te Presidenti betohen edhe ata të tjerët që zgjedh parlamenti dhe që zgjedh Gjykata e Lartë. Pse? Sepse si kryetar i këtij shteti, që detyrë kryesore ka të mbrojë interesat e shtetit dhe jo të pushtetit, të qeverisë sot, apo të opozitës, të qeverisë nesër. Sot kryetari i shtetit verifikon edhe integritetin e institucioneve të tjera se si ato kanë vepruar përsa i takon zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Dhe nëse ka një mosmarrëveshje, kjo mosmarrëveshje shkon në Gjykatë Kushtetuese dhe nuk shkon te noteria buzë Lanës.

**Gazetari:** Zoti President, më lejoni që pyetjen që bëra pak më parë, t’jua formuloj në një formë tjetër! Në qershorin e vitit të kaluar, përse nuk lejuat që qytetarët të çlironin “Bastijën”?

**Presidenti Meta:** Unë kam qenë dhe jam për zgjidhje institucionale. Koha më ka dhënë të drejtë. Unë e kam bërë të qartë që me zgjedhje njëpartiake, – sikur të ishin edhe të ligjshme, – për më tepër se ato u bënë të paligjshme, Shqipëria kurrë nuk do të hapte negociatat, sikurse edhe ndodhi. Mjafton të keni parasysh kushtet e reja që zgjodhi Bundestagu, ku një nga këto është Gjykata Kushtetuese, dhe një tjetër që lidhet me integritetin e Gjykatës Kushtetuese, për zgjedhjet e 30 qershorit, meqë ato ishin të paligjshme. Mjafton të lexosh raportin e OSBE/ODIHR-it që thotë edhe këtë gjë shumë qartë, që është pjesë tjetër e

grushtit të shtetit. Thotë që dekreti i Presidentit për zgjedhjet e 13 tetorit nuk u botua në Fletoren Zyrtare sipas parashikimit të ligjit. Si mund të ndodhë kjo gjë në një shtet normal, në një shtet të së drejtës?! Pra në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, ditën e shtunë, që është ditë pushimi, del ministrja e Drejtësisë në punë. Ministrja i jep një shkresë kryetarit të..., i jep një porosi atyre që të publikojnë një vendim që s'kishte fare lidhje me këtë, një vendim që s'kishte lidhje fare me këtë, sepse është e diçkaje tjetër. Të një institucioni të pavarur, që e kishte botuar atë atje ku i takon, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në seksionin për KED-në më 22 shtator. Dhe pastaj merr një shkresë më pas nga Kuvendi që gjoja sa për ta vënë në dijeni, ndërkohë që këta s'i kanë bërë asnjë kërkesë zyrtare për të ruajtur veten e tyre, për të bërë një botim të tillë, sepse nuk mund ta bënë në emër të një organi tjetër. Dhe të gjitha këto gjëra ndodhin ditën e shtunë, ndërsa dekreti i Presidentit që e dinte gjithë bota, nuk botohet në Fletoren Zyrtare.

Unë them atë që nuk jemi pastaj pushteti i grushtit të shtetit!

**Gazetari:** Ju vetë si kryetar shteti, por edhe vetë drejtuesit e opozitës, a u shantazhuat, a u trembët nga telefona e Ndihmës Zëvendëssekretarit të Shtetit, Palmer?

**Presidenti Meta:** Ju nuk jeni këtu për të bërë shaka! Unë kam respekt për të gjithë partnerët dhe kam folur me ta për të gjitha këto shqetësime me të cilat po ndeshet Shqipëria. Dhe për fat të keq i kam parashikuar prej kohësh. Se ç'po bëjnë ata, kjo është përgjegjësia e tyre. Veprimet e mia janë të drejtpërdrejta, janë tepër korrekte dhe koha më ka

dhënë mua gjithmonë të drejtë në të gjitha veprimet dhe qëndrimet e mia.

Se çfarë ka bërë opozita, është çështje e opozitës, nuk është çështja ime.

**Gazetari:**Ju keni një kalendar. Si mund të zgjidhet kjo krizë? Çfarë keni domethënë? Nga kontaktet me ndërkombëtarët? A ka një projekt të darkodësuar nga të gjithë?

**Presidenti Meta:**Zgjidhja ..., nuk pres ndonjë zgjidhje nga ndërkombëtarët. Ata po të donin zgjidhjen e kishin dhënë këtu. Zgjidhjet kanë qenë këtu. Zgjidhjet janë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë që ne e kemi bërë bashkë me ndërkombëtarët. Dhe për atë Kushtetutë që u votua me 140 vota, ne na u puthën në buzë dy ambasadorë të rëndësishëm, nga gëzimi i madh që u bë me konsensus! Ashtu sikurse për fat të keq bekuan kapjen antikushtetuese të Prokurorisë me 69 vota, në kundërshtim të hapur me përcaktimin kushtetutes të 84 votave.

Tani nuk jam duke i hyrë kësaj çështjeje. Nuk e pres zgjidhjen te diplomatë që sot janë në Shqipëri, dhe nesër ikin në Tashkistan, apo ikin në Afganistan apo dalin në pension. Unë zgjidhjen e pres vetëm te respektimi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe populli shqiptar duhet ta kuptojë se mund t'i mbrojë të drejtat e veta, vetëm duke mbrojtur Kushtetutën e Republikës dhe duke i treguar vendin kujdo, që nga Presidenti i Republikës dhe cilitdo tjetër që cenon Kushtetutën. Ky është themeli që i bashkon të gjithë shqiptarët dhe është e vetmja mënyrë për të

**zgjidhur mosmarrëveshjet tona të përditshme dhe të përhershme! Sepse janë mosmarrëveshje që vinë vetënga ekzistenca e demokracisë. Prandaj unë kam thirrur popullin. Populli duhet të thotë fjalën e tij! Dhe unë kam besim se populli shqiptar do ta thotë fjalën e tij.**

**Gazetari:** Çfarë duhet të bëjë populli?

**Presidenti Meta:** Populli në radhë të parë, me pjesëmarrjen. Pastaj të tjerat do t'i komunikojmë në miting. Në manifestim. Kjo është fjala më e mirë.

**Gazetari:** Dakord. Ju e thirrët popullin, mirëpo populli opozitar, ose më saktë drejtuesit e popullit opozitar hezituan t'i përgjigjeshin thirrjes suaj. Në mos gabohem ju deklaratën e keni bërë...?

**Presidenti Meta:** Unë nuk kam pasur asnjë preferencë.

**Gazetari:** ...në datën, domethënë pesë ditë më pas, pasi ju thirrët zotin Basha, që tha se mbështesin thirrjen e Presidentit, ndërkohë që populli opozitar priste tekstin pas pesë minutash, jo pas pesë ditësh? Si e shpjegoni këtë?

**Presidenti Meta:** *Unë i kam thirrur të dyja palët, për mirëkuptim, nëmënyrë të vazhdueshme, edhe për rastin konkret. Unë i kam konsumuar të gjitha veprimet e mia me parlamentin apo me mazhorancën. Ua kam bërë të qartë: Zotërinj, mos bëni këto lojëra! Hajdeni të bashkëpunojmë, të mos përplasemi, sepse ju nukmund të rrëmbeni në këtë mënyrë Gjykatën Kushtetuese, nëmënyrë antikushtetuesese. Ju bëni detyrat tuaja sipas ligjit, sipas Kushtetutës! Ato*

*përgjegjësi që ia janë caktuar parlamentit. Unë bëj të miat si President. Të bashkëpunojmë në respekt të Kushtetutës!*

Ia kam bërë edhe mazhorancës të gjitha kërkesat e mia dhe sqarimet, por edhe paralajmërimet se po shkoni shumë larg se sa mendoni edheju vetë. Por çfarë të bëjmë tani?! Ata kanë hyrë në një skenar pengmarrjeje dhe nuk janë të lirë në veprimet e tyre dhe nuk janë sovranë për të marrë vendime që ushërbejnë vendit, që u shërbejnë qytetarëve shqiptarë, që i shërbejnë edhe interesit publik.

*Ata nguten, kanë një panik të madh. Është çështja e tyre. Por edhe shqiptarët duhet të nguten, duhet të reagojnë dhe duhet ta kuptojnë të gjithë se me vullnetin e sovranit askush nuk duhet të luajë, që nga Presidenti i Republikës.*

*Thirra opozitën, sepse ishin disa fakte. Përse ta thërrisja Edi Ramën?! Ta thërrisja për veprat kriminale të Etilda Gjonajt që ai i dinte se është e qartë që fakti se ajo ajo nuk jep dorëheqjen dhe fakti se ai nuk kërkon shkarkimin e saj, është e qartë se ajo e ka bërë me porosi dhe me mbrojtje politike. Për çfarë ta thërrisja?! Ai i dinte këto gjëra. Jam i sigurt se kryetari i opozitës nuk i dinte këto gjëra. Dhe përfaqësues të tjerë të opozitës nuk i dinin këto gjëra. Kështu që Presidenti i Republikës ua sqaroi edhe atyre këtë veprimtari kriminale, që bashkëngjitur edhe me skenarin e fundit të provokimit për të kaluar ligjin antikushtetues për rrëmbimin mafioz të Gjykatës Kushtetuese, për të pasur Gjykatë Kushtetuese me gjyqtarë të standardit Dvorani, Arta dhe Etilda se çfarë pasojash mund të ketë kjo për të gjithë Shqipërinë dhe për vetë opozitën, e cila duhet të jetë mbrojtësja e parë e demokracisë dhe e të drejtave të çdo qytetari shqiptari që i cenohen.*

*Por unë nuk kam përjashtuar njeri dhe nuk kam bërë thirrje që të vinë disa parti kundër disa të tjerave. **Unë mendoj se socialistëve u takon të parëve të vinë në Bulevard. Përse u takon socialistëve? Sepse ata kanë pasur kontributin kryesor me tolerancën dhe përgjegjshmërinë që kanë treguar në 1998-n për ta bërë Shqipërinë me një kushtetutë mjaft demokratike.** Ata kanë përgjegjësinë në 2008-n që nuk e kuptuan skenarin e organizatës ndërkombëtare atëhere për ndryshimet që u bënë, për të ardhur demokracia në këtë situatë që jemi sot. Dhe ata janë më të përjashtuar se kushdo tjetër nga qeverisja, nga llogaridhënia. Kështu që jam i sigurt se ata do të vinë për të shpëtuar dinjitetin e tyre.*

**Gazetari:** Këmbëngul te qëndrimi i kryetarit të opozitës, zotit Basha.

**Presidenti Meta:** Junuk keni përse këmbëngulni për këtë gjë! Ju mund ta merrni në intervistë dhe ta pyesni! Unë nuk përgjigjem dot për të.

**Gazetari:** E akuzojnë se ka një pakt të dytë të tij me Ramën. A besoni ju se në këtë ekuacionin tuaj të 2 marsit do ta keni plotësisht, edhe...?

**Presidenti Meta:** Unë asnjëherë nuk kam pasur asnjë pakt, me askënd në Shqipëri kundër Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kundër sovranitetit të popullit shqiptar, kundër demokracisë në këtë vend. Asnjëherë nuk kam pasur pakt.

Për të qenë në pozitë, për të ardhur në pushtet, këto janë histori të tjera. Por kurrë në historinë e Shqipërisë, një pakt në cenim të Kushtetutës dhe të parimeve kushtetuese!

Një pakt për të shkelur ligjin në mënyrë të qëllimshme dhe në dëm të vetë Kushtetutës. Asnjëherë dhe për as një gjë!

Një qëndrim që t'i iki një përgjegjësie për një çështje të rëndësishme kombëtare, e cila është emergjente apo kombëtare apo të merrem me çështje të tjera të vogla apo anësore.

Kështu që unë kam pakt për mbrojtjen e Kushtetutës dhe e kam edhe për detyrën, që kur kam vënë dorën mbi Kushtetutën e Shqipërisë dhe deri më 24 korrik 2022 do ta mbroj atë edhe me jetën time dhe me gjithçka tjetër, duke treguar që jam jo vetëm President i Republikës, por jam dhe do të jem edhe ushtari i parë i Republikës.

**Nuk ka Republikë pa President, zotëri!**

**Ka edhe Republika pa kryeministër.**

**Gazetari:** Si ta kuptojmë këtë?

**Presidenti Meta:** Nukka republikë pa president në botë. Më gjeni një republikë pa president!

**Gazetari:** Jo!

**Presidenti Meta:** Qartë! Vazhdojmë!

**Gazetari:** Qartë. Nuk njihet kjo si procedurë. Por që mund të jemi në një republikë me president, por pa kryeministër donit të thonit?



**Presidenti Meta:** *Unë ju thashë që nuk ka republikë pa president në botë! Të tjerat, i thonë shqiptarët nga 2 marsi e në vazhdim, deri sa të rivendosim plotësisht rendin kushtetues demokratik dhe llogaridhënës siç është në Kushtetutën e Shqipërisë, që e ka votuar populli shqiptar, sovran, me votën e tij me referendum, më 22 nëntor 1998.*

**Gazetari:** Kjo do të thotë që do të shpërndani Parlamentin?

**Presidenti Meta:** *Nuk është përgjegjësia ime nëse Parlamenti sillet vetë si i shpërndarë, si një institucion i shpartalluar që merr pjesë në veprime të tilla mafioze dhe bën akte mjaft të rënda të cilat do të vazhdojmë t'ia ekspozojmë popullit shqiptar. Ky nuk është faji im.*

**Gazetari:** Megjithatë duhet një goditje mëshire. Do t'ia jepni?

**Presidenti Meta:** Për ata të cilët kërkojnë të zhdukin demokracinë, llogaridhënien në këtë vend me qëllim që t'ia dorëzojmë sovranitetin e këtij vendi një organizate ndërkombëtare e cila ka synuar dhe synon shpopullimin e Shqipërisë përmes kësaj bande për fat të keq, nuk do të ketë asnjë tolerancë.

**Gazetari:** Si duhet ta kuptojmë këtë? Domethënë që jeni duke e menduar shpërndarjen e Parlamentit?

**Presidenti Meta:** *Kjo do të thotë që mbi Presidentin, i cili për fat të keq është i vetmi institucion legjitim dhe për arsye se nuk është zgjedhur nga ky Parlament, por nga Parlamenti i mëparshëm, qëndron vetëm Kushtetuta dhe një Gjykatë Kushtetuese me integritet, pra sipas Kushtetutës dhe mbi këtë qëndron vetëm populli dhe Zoti! Dhe unë i bindem vetëm*

*vullnetit të tyre. Ata të tregojnë vullnetin e tyre dhe pastaj të jenë të sigurt që Ilir Meta do ta interpretojë vullnetin e tyre ashtu siç duhet për rivendosjen e plotë të rendit kushtetues dhe për të vënë çdo shqiptar përballë provës dhe çdo politikan që deri tani mund të ketë bërë lojëra të dyfishta apo të trefishta e të katërfishta. E që nuk është i lirë në vendimmarrjen e vet për t'i dalë zot fateve të popullit shqiptar.*

Këtu nuk bëhet fjalë për fatet e Ilir Metës. Kjo është gjëja më e parëndësishme dhe nuk më intereson fare Ilir Meta. Ilir Meta në këtë vend i ka provuar të gjitha funksionet. I ka provuar të gjitha pushtetet: kryeministër që 30 vjeç dhe ka ikur vetë nga ajo detyrë. I luteshin që të rrinte, por nuk pranonte për arsyet e veta. Kam bërë çdo gjë, sot është President i Republikës, është ushtari i parë i Republikës.

Shikoni zotëri betimin e Presidentit të SHBA-ve, tri herë për të mbrojtur vendin e vet, Kushtetutën. *“To preserve, to protect and to defend!” (Për ta mirëmbajtur, për ta ruajtur si dhe për mbrojtur!)* Edhe në të ardhmen duhet ta formulojmë edhe më mirë betimin e Presidentit dhe betimin e çdo njeriu që vë dorën mbi Kushtetutë.

**Gazetari:** Po nëse qytetaret më datë 2 mars qytetarët iu kërkojnë të shpërndani parlamentin, do ta bëni?

**Presidenti Meta:** *Unë jam i sigurt që do të jemi në një sintoni të plotë me qytetarët. E rëndësishme është nëse ata pranojnë apo nuk pranojnë më, që një grup puçistësh të rrëmbejnë çdo të drejtë të tyre kushtetuese dhe njerëzore, të lirisë së tyre, të llogaridhënies në këtë vend para tyre, që paguajnë taksat edhe që paguajnë borxhet që po shkon në stratosferë.*

*Dhe absolutisht të jenë të sigurt se Presidenti i Republikës do të bëjë detyrën e tij në mënyrën më shembullore për rivendosjen e rendit kushtetues dhe do t'i kërkojë të gjithëve të bëjnë detyrën e tyre, të gjithë aktorëve të tjerë.*

*Këtu nuk mund t'i shmangemi dot kësaj historie. Jemi në një përballje finale me puçistët, nuk ka temë tjetër më të rëndësishme në Shqipëri deri në momentin që do të zgjidhim këtë çështje.*

**Gazetari:** Dhe atë akt do ta bëni në atë moment, që atë ditë?

**Presidenti Meta:** Çdo ditë do të ketë detaje të reja, do të ketë dinamika të reja.

**Gazetari:** Do të doja t'ju pyesja lidhur me një gjë, sepse ju në dijeninë time heshtët për një skandal që kanë zbuluar së fundmi në Prishtinë që për gazin lotsjellës që erdhi nga Kosova për protestat. A i keni kërkuar sqarime nga autoritetet shqiptare?

**Presidenti Meta:** Edhe më këtë çështje do të merremi, këtu ka skandale përditë, përnatë. Unë si President aktualisht jam i përqendruar në këtë çështje madhore dhe këtë betejë finale dhe nuk dua të shfokusohem, sepse është edhe vetë Rilindja e interesuar për të shpikur skandal pas skandali, për të shmangur fokusin nga çështja kryesore, nga rrëmbimi mafioz që kërkon që t'i bëjë Kushtetutës së Shqipërisë dhe nga akti i fundit për të ekzekutuar Kushtetutën dhe të gjithë të drejtat kushtetuese të gjithë qytetarëve të Shqipërisë, qofshin socialistë apo demokratë,

ballistë apo legalistë, apo komunistë apo çdo gjë tjetër apo pa parti.

**Gazetari:** Deri tani zoti President rreth 6 kryetarë bashkish kanë mbetur viktima të ligjit të dekriminalizimit. Postet e tyre janë vakante dhe duhet të zhvillohen zgjedhje. Si mendoni se duhet zgjidhur kjo çështje?

**Presidenti Meta:** Lidhur me këtë çështje mund t'i drejtoheni zëdhënësit tim. Kjo nuk ekziston si çështje e rëndësishme në axhendën e Presidentit të Republikës.

Në axhendën e Presidentit të Republikës është vetëm një çështje e rëndësishme, organizimi i të gjithë qytetarëve, i të gjitha popullit pa asnjë dallim partiak, pa asnjë dallim krahinor, pa asnjë dallim besimi për të mbrojtur Republikën e Shqipërisë.

**Gazetari:** Zoti President, ju falënderoj për intervistën!

**Presidenti Meta:** Faleminderit edhe ju!